



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Ankesa në procedurën e verifikimit.
2. Obligohet Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

për ndryshimin dhe shfuqizimin e pjesshëm të Vendimeve Përfundimtare Nr.03/36 datë 07.09.2011, Nr.14/52 datë 14.12.2011 dhe Nr.05/90 datë 05.09.2012

1. Ndryshohen dhe shfuqizohet pjesërisht Vendimet Përfundimtare si në vijim:
 - Vendimi Përfundimtar nr.03/36 datë 07.09.2011, shfuqizohen shpronësimet dhe vlerësimet për interes publik Zona Kadastrale Temeqinë, Komuna Malishevë, për pronat me numër rendor: 68 dhe 69.
 - Vendimi Përfundimtar nr.14/52 datë 14.12.2011, shfuqizohen shpronësimet dhe vlerësimet për interes publik Zona Kadastrale Arllat, Komuna Drenas, për pronat me numër rendor: 15, 16, 37 dhe 101.
 - Vendimi Përfundimtar nr.05/90 datë 05/09.2012, shfuqizohen shpronësimet dhe vlerësimet për interes publik Zona Kadastrale Arllat, Komuna Drenas, për pronat me numër rendor: 10, 11, 14, 15, 16, 17, 19, 22, 23, 29, 44, 46, 47 dhe 65.
2. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë, Zona Kadastrale Temeqinë dhe Bellanicë, Komuna Malishevë dhe Zona Kadastrale Arllat, Komuna Drenas, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të

cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e bashkangjitura këtij vendimi.

4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
6. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ për vitin 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshihet:
 - 1.1. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë (MF).
2. Nga Programi Legjislativ për vitin 2012 hiqet:
 - 2.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-033 për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe të Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e saj (ZKM).
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit Qeveritar për hartimin dhe finalizimin e Koncept Dokumentit për regjistrin e mërgimtarëve

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Diasporës për themelimin e Komisionit Qeveritar për hartimin dhe finalizimin e Koncept Dokumentit për regjistrin e mërgimtarëve në këtë përbërje:
 - 1.1. Lulzim Dragusha, Këshilltar i Ministrit të MeD - Kryesues;
 - 1.2. Mentor Borovci, Drejtor i DL-së në MeD - Zëvendës kryesues;
 - 1.3. Isa Krasniqi, Kryeshf Ekzekutiv i ASK/ZKM - anëtar;
 - 1.4. Blerim Camaj - Kryeshf Ekzekutiv i ARC/MPB - anëtar;
 - 1.5. Besim M. Kajtazi-Drejtor ZL/ZKM - anëtar;
 - 1.6. Ruzhdi Halili- Drejtor ZPS/ZKM - anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues MPJ - anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues MF - anëtar; dhe
 - 1.9. Përfaqësues i Agjencisë së Statistikave të Kosovës/ZKM - anëtar.
2. Në cilësinë e ekspertëve dhe vëzhguesve Komisioni mund të ftojë:
 - 2.1. Përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës/ZKM;
 - 2.2. Përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës;
 - 2.3. Përfaqësues nga IOM;
 - 2.4. Përfaqësues nga Shoqëria civile.
3. Komisioni do të hartojë dhe paraqet për miratim në Qeveri Koncept dokumentin lidhur me mënyrën dhe opsionet e regjistrimit të mërgimtarëve të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh përvojat më të mira evropiane dhe më gjerë.

4. Koncept Dokumenti duhet të hartohet në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
5. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës/ZKM të ofrojë ndihmë profesionale në hartimin e koncept dokumentit.
6. Obligohen të gjitha ministritë (duke përfshirë edhe agjencitë dhe njësitë përkatëse në kuadër të ministrive) të bashkëpunojnë me Komisionin dhe t'u përgjigjen kërkesave të Komisionit.
7. Sekretarët e përgjithshëm të Ministrive janë përgjegjës që në Ministritë përkatëse të sigurohet mbarëvajtja dhe realizimi i përgjegjësive të përcaktuara në këtë Vendim.
8. Ministria e Diasporës ofron ndihmën e nevojshme për punën e Komisionit.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Nëntëmujor i Buxhetit për vitin 2012.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 73 të Ligjit nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për Kryeshefin e Agjencisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Hajredin Kuçi, Zëvendëskryeministër, Kryesues
 - 1.2. Z. Mahir Yagcilar, Ministër i Administratës Publike, anëtar;
 - 1.3. Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 1.4. Z. Demush Shasha, Sekretar i Përgjithshëm në MIE, anëtar;
 - 1.5. Z. Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm në MKRS, anëtar,
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuar me Ligjin nr.03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës rregulloren nr.06/2012 për pozita e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera përcjellëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/97
Datë: 24.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, nenit 21 të Rregullores Nr. 23/2012 për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Sekretaria e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të Dëshmorit të kombit, Invalidit, Veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Sekretaria).
2. Sekretaria mbështet Komisionin në të gjitha punët administrative duke përfshirë:
 - 2.1. Pranimin e të gjithë dokumentacionit që posedojnë shoqatat e dala nga lufta dhe Zyrat përkatëse të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 2.2. Pranimin dhe bartjen e të gjithë dokumentacionit të Ish TMK-së i cili ka të bëjë me listat e Ushtarëve të UÇK-së dhe të mbajë në dispozicion të Komisionit;
 - 2.3. Mbështetjen teknike në përpilimin e regjistrave të aplikuesve sipas kategorive;
 - 2.4. Menaxhimin e e-mail adresës së komisionit;
 - 2.5. Menaxhimin me procedurat e ankimit;
 - 2.6. Mbajtjen e procesverbalit të takimeve;
 - 2.7. Njoftimin e anëtarëve të Komisionit për rendin e ditës, kohën dhe vendin e takimit;
 - 2.8. Përgatitjen projekt buxhetit për shpenzime gjatë punës së komisionit.
 - 2.9. Kryerjen e të gjitha punëve tjera sipas kërkesës së Kryetarit të Komisionit për mbarëvajtjen e punës.

3. Sekretaria udhëhiqet nga drejtori i Zyrës për Çështje të Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në pajtim me nenin 17 (2.4) të Ligjit Nr. 04/L-054 .
4. Personeli i Sekretarisë përbëhet nga këto pozita:
 - 4.1. Udhëheqësi i Sekretarisë-Drejtori i ZVL-UÇK-së;
 - 4.2. Zyrtar administrativ me nivel të pagës 500 (pesëqind) euro bruto në muaj;
 - 4.3. Tre (3) Punëtor Administrativ me nivel të pagës 400 (katërqind) euro bruto në muaj.
5. Angazhimi i këtyre pozitave bëhet me kontratë mbi vepër për një periudhë të caktuar sipas mandatit të Komisionit, dhe përzgjidhen nga ZVL-UÇK në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit Qeveritar.
6. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së siguron hapësirën për Sekretari, me të gjitha pajisjet për punë, duke përfshirë materialin shpenzues dhe një makinë.
7. Ndahen mjete Financiare në vlerë prej 7,000.00 (shtatë mijë) euro për nevojat e Sekretarisë nga pika 1. e këtij vendimi.
8. Mjetet nga pika 7. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Zyrën për Veteranët e Luftës/Zyrën e Kryeministrit.
9. Buxheti tjetër i nevojshëm për punën e Komisionit me këtë vendim të Qeverisë bartet në ZKM-ZVL;
10. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë